

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		22/01/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	40001	3483	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Palët e marrëveshjes:

- Komuna e Drenasit, me përfaqësues z.Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit
- Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, përfaqësuar nga, z.Afrim Gjeli

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje të bashkëpunimit është ofrimi i shërbimeve shëndetësore nga Qendra Kryesore e Mjekesisë Familjare në Komunën e Drenasit (në vijim: QKMF), për nevojat e punëtorëve të Njesisë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Komunes së Drenasit, duke synuar mbështetjen e mirëqenies së tyre fizike dhe shëndetësore

Neni 2 Detyrat e Komunes së Drenasit/QKMF-së

- Komuna e Drenasit, përmes QKMF-së, do të ofrojë shërbime rutinore vjetore për punëtorët e Njesisë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Komunës së Drenasit
- QKMF-ja, ka për obligim të kryejë të gjitha shërbimet shëndetësore rutinore dhe analizat laboratorike që ofrohen nga kjo qendër për punëtorët e Njesisë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Komunes së Drenasit
- Shërbimet rutinore vjetore, një (1) here në vit, për punëtorët e Njesisë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Komunes së Drenasit do të ofrohen pa pagesë
- Komuna e Drenasit, përmes QKMF-së dhe Njesisë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Komunes së Drenasit, do të shkëmbejnë informata të ndërsjella sipas nevojave të institucioneve shëndetësore ose të NJPZSH-së.

Neni 3 Detyrat e Zjarrfikësve

- Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Komunës së Drenasit, merr përsipër përpilimin e planit të vizitave për punonjësit e saj në baza vjetore.
- Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Komunës së Drenasit do të hartojë plane për vizitat shëndetësore të 3-5 punonjësve ç'do muaj.
- Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Komunës së Drenasit, do të përshtatet me orarin që do të caktohet nga QKMF-ja, për kryerjen e shërbimeve.

Neni4
Mosmarrëveshjet

1. Ç'do kontest apo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit, do të zgjidhet në frymë bashkëpunimi dhe me qëllimin e përbashkët të ofrimit të shërbimeve për Njësinë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Komunës së Drenasit,
2. Ne rast të deshtimit të zgjedhjes së kontestit përmes frymës bashkëpunuese, palet përkatëse mund ti drejtohen autoriteteve kompetente
3. Në rast të krijimit të rrethanave të reja, palet me dakordim të dyanshëm mund të lidhin aneks-marreveshje për adresimin e rrethanave të reja.
4. Shkëputja e kësaj marrëveshje bashkëpunimi, mund të bëhet me njoftim paraprak prej 30 ditësh nga pala përkatëse.

Neni5
Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje do të zgjasë për dy (2) vite nga data e nënshkrimit
2. Marreveshja mund të vazhdohet për një periudhë shtesë në rast se vlerësohet nevoja.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është e nënshkruar në katër (4) kopje origjinale, nga dy (2) për secilën palë nënshkruese dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Kjo marrëveshje hynë në fuqi me: 22 / 01 / 2025

PALËT NËNSHKRUESE:

Ramiz Lladrovci
Kryetar i Komunës së Drenasit



Afrim Gjeli
Njësia Profesionale e Zjarrfikësve

